

VENDIM
Nr. 972, datë 2.12.2015

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË
NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE “MAMËZ-KALIMASH”, OBJEKTI “KROI I
PULAVE”, TË RRETHIT KUKËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“AMERIKA GROUP” SHPK, PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NË
SHFRYTËZIMIN E KROMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullimore prej 29,5 (njëzet e nëntë presje pesë) ha, në ngastrat 92a, 92b, 93a, 93b, 94a dhe 94b, të ekonomisë pyjore “Mamëz-Kalimash”, objekt i aktivitetit minerar, që do të përdoret nga shoqëria “Amerika Group” sh.p.k., për shfrytëzimin e kromit, të hiqet nga Fondi Pyjor dhe Kullor Publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes së hequr e infrastrukturës së saj paguhen nga shoqëria “Amerika Group” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Amerika Group” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 3 (tri) viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 88,5 (tetëdhjetë e tetë presje pesë) ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Amerika Group” sh.p.k., nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin e projekteve teknike, lidhur me detyrimet, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

5. Sipërfaqja pyjore dhe kullimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Amerika Group” sh.p.k.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullimore, të identifikuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore / kullimore” dhe ta regjistrojë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Amerika Group” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet fond pyjor dhe kullor.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE E NËNNGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI
PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NË OBJEKTIN
“KROI I PULAVE”, KUKËS, NGA SHOQËRIA “AMERIKA GROUP”, SHPK

QARKU SHKODËR

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullosore	Ngastra	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
KU 32 00	Mamez-Kalimash	92a	Ministria Mjedisit	4.6
KU 32 00	Mamez-Kalimash	92b	Ministria Mjedisit	9.68
KU 32 00	Mamez-Kalimash	93a	Ministria Mjedisit	1.84
KU 32 00	Mamez-Kalimash	93b	Ministria Mjedisit	9.41
KU 32 00	Mamez-Kalimash	94a	Ministria Mjedisit	1.13
KU 32 00	Mamez-Kalimash	94b	Ministria Mjedisit	2.84
GJITHSEJ				29.50

